



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

A.K.P.A.
Nr 2338 Prot.
Datë, më 10.09.2026

MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE TIRANË

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE INDUSTRIALE "PAVARËSIA " VLORE

Nr. 805 Prot

Vlorë , më 10.09.2026

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele .

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore ,

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun".

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 759 datë ,30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimit e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit "(të ndryshuar),

Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE "PAVARESIA "VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicione pune :

Dega-Teknologji informacioni dhe komunikimi, mësues të teorisë dhe /ose të praktikës profesionale , 2 mësimëdhënës me kohë të pjesshme (14 orë/javore)

1. Kriteret të përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar

b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën

c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale

d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar

e) të demonstrojë vlera të larta të etikës , sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Bulevardi kryesor, "Ismail Qemali " Vlorë , Lagjia "Pavarësia", E-mail: industriale11@yahoo.com



Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për mësues të teorisë dhe /ose të praktikës profesionale (me kohë të pjeshme) në ofruesit e AFP-së për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme ,në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit public të AFP-së .

b) të ketë të paktën 1(një) vit përvojë pune në fushën ,më të cilat ka kryer studimet

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

d) aftësi të tjera nëse kërkohen

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për lëvizje paralele , duhet të përfshijë: -

- letërmotivimin për pozicionin;

- jetëshkrimin (CV-në);

- kartën e identitetit;

- diplomën + listen e notave

- librezën e punës;

- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;

- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi, të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre ;

- Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit public të AFP-së, brenda datës ,

17/09/2026

3. Vlerësimi I kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759 datë 30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit "(të ndryshuar),

DREJTOR

ING. GENTIAN BOCI

